



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



01 Nr./Br. 01101-19336
Data/Datum 27.09.2023

Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. /2023
Datë: 26.09.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 21 paragrafi 1.3 të Ligjit nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt.26.09.2023, pas diskutimeve lidhur me pikën e 7 të rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesës së DUMM-së për dhënien në shfrytëzim të pjesës së pronës publike për vendosjen e stabilimenteve shpërndarëse të rrjetit elektor-energjetik të tensionit të mesëm dhe të Ultë , e miratoi këtë:

V e n d i m

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për lejin e shfrytëzimit dhe krijimin e servitutit kompanisë KEDS në pronën komunale për vendosjen e stabilimentit të ri shpërndarës .
2. Shfrytëzimi dhe krijimin e servitutit në pronën shoqërore - Rrugë Publike caktohet në parcelën P-70705053-00435-0 Z. K Orize (LP Dobrosh), për vendosjen e stabilimentit të ri shpërndarës tipi A1 lokacioni në rrugën “ Iballe” në sipërfaqe prej 34.0m² .
3. Lidhur me kohëzgjatjen e të drejtës së servitutit, e njëjta do të rregullohet sipas dispozitave Ligjore që rregullojnë këtë të drejtë.
4. Autorizohen organet e administratës komunale që të ndjekin procedurat ligjore për zbatimin e këtij vendimi sipas shënimeve të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës .
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit,



Arbënesha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC
OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data:	05.09.2023
Numër:	07/zyrtar
Për:	Kryesuesen e Kuvendit Komunal, Gjakovë
C.C.	Anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, Gjakovë
Nga:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejtore, Arben Bakalli
Lënda:	Kërkesë për dhënien në shfrytëzim të pjesës së pronës publike për vendosjen e stabilimentit shpërndarës të rrjetit elektro energjetik të tensionit të mesëm dhe të ultë

Të nderuar,

Bazuar në Ligjin Nr.05/L-184 për energjinë, kompania KEDS pranë Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit ka parashtruar kërkesa për dhënien e Pëlqimit për revidim dhe rekonstruimin e një pjese një rrjetit elektro energjetik të projektit LP DOBROSHI në Komunën e Gjakovës, e cila kërkesë përfshinë revidimin dhe rekonstruimin e LP dhe ngritjen e stabilimentit të ri.

Nga trajtimi i kërkesës së parashtruara rezulton se përveç rehabilitimit të rrjetit ekzistues është propozuar dhe lokacioni për vendosjen e stabilimentit të ri shpërndarës. Lokacioni ku është planifikuar të vendoset stabilimenti shpërndarës në i përket hapësirës publike me karakter rrugë publike. Bazuar në Ligjin Nr.05/L-184 për energjinë dhe Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor, stabilimentet janë pjesë e infrastrukturës teknike të domosdoshme, andaj dhe Ju drejtohem për dhënien në shfrytëzim të hapësirës së nevojshme për vendosjen e stabilimentit.

Lokacioni – hapësira e kërkuar në shfrytëzim është:

1. Pjesë e parcelës me numër P-70705053-00435-0 Z.K. Orize (LP Dobrosh) pronë shoqërore-rrugë publike, stabiliment i ri shpërndarës tipi A1- lokacioni në rrugën “ Iballe” në sipërfaqe prej 34.0m²;

Bazuar në elaborimin e më lartë shënuar dhe legjislacionit në fuqi, Ju drejtohem për dhënien në shfrytëzim të hapësirës pjesë të rrugës publike (lokale) për vendosjen e stabilimentit të ri elektro-energjetike (stabilimente shpërndarëse).

Me respekt!

Bashkangjitur gjeni kërkesën dhe dokumentet kadastrale të lokacionit të kërkuara për shfrytëzim.

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Postal address: Nëna Tereze Gjakovë, Kosovë

Tel: +381 390 322 452, 323 210, 320 070 Fax: +381 390 322 452

www.gjakova-komuna.org

 KOMPANIJA KOSOVARË PËR DISTRIBUTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE KOSOVAN ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY J.S.C. KOSOVA	NJËSIA INVESTIMET	Nr.	KEDS-DIV-F-DIV-05
	KËRKESË PËR LEJE NDËRTIMI(PËLQIM) PËR HAPËSIRË KANALEVE DHE NDËRTIMIN E TRAFOSTACIONEVE 10(20)/0.4kV	Faqe	Faqe 1 prej 2
		Versioni	1.0

3356


20 APR 2023

Data:	20.04.2023
Për:	DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT KOMUNA GJAKOVË
Nga:	OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DEPARTAMENTI I INVESTIMEVE PRISHTINË
Tema:	KËRKESË PËR DHËNJEN E PËLQIMIT PËR REKONSTRUIMIN E RRJETIT TË TENSIONIT TË MESËM 10(20)kV
Lënda:	Projekti me Plan Investiv 2021 "LP 10(20)kV Dobroshi" – i Reviduar

Në bazë të planit investiv 2021 për Zgjerim dhe Përforcim të Rrjetit Distributiv, KEDS ka paraparë ndërtimin e linjave të reja nëntokësore 10(20)kV dhe linjave ajrore nga NS Gjakova 1 35/10(20)kV deri te fshati Botushë. Me ndërtimin e këtyre linjave 10(20)kV të Tensionit të Mesëm do të mundësohet furnizimi i trafostacioneve ekzistuese që përfshihen fshatrat Meje, Racaj, Sheremet, Dobrosh, Molliq, Brovinë dhe Botushë, andaj kërkohet nga titulli i lartshënuar që të lëshohet **PËLQIMI** për rekonstruimin e rrjetit të tensionit të mesëm 10(20)kV.

Me këtë projekt është planifikuar të bëhet :

1. Zhvendosja e trafostacionit ekzistues 10(20)/0.4kV "Rrypaj 1" në kuadër të parcelës me nr. 00015-0 ZK Kodra e Hutit (pronë shoqërore-rrugë publike), në hapësirën prej 9[m²].
2. Ndërtimi i Stabilimentit Shpërndarës të tipit A1 me dimensione (6100x2200x2600) mm në kuadër të parcelës me nr. 00435-0 ZK Orize (pronë shoqërore-rrugë publike), në hapësirën prej 34[m²].
3. Zëvendësimi i trafostacionit ekzistues Separacioni Koshare me trafo shtyllë metalike në parcelën e njejtë.
4. Rekonstruimi i trafostacioneve ekzistuese d.m.th. në ato trafostacione ku nuk janë në funksion kthinat e tensionit të mesëm 10(20)kV do të demontohen dhe do të montohen kthinat e reja të tensionit të mesëm 10(20)kV.
5. Ndërimi i transformatorëve nga niveli i tensionit 10kV në 10(20)kV
6. Ngritja e fuqisë së transformatorëve në disa prej trafostacioneve ekzistuese.
7. Rekonstruimi i rrjetit ajror i Tensionit të Mesëm 10(20)kV, zëvendësimi i shtyllave të vjetra me ato të reja të betonit 12m, zëvendësimi i përçuesit të vjetër me atë të ri Al/Ce 55/6mm², Al/Ce 50/8mm², Al/Ce 95/15mm² dhe me bistik kabëll XHE 48/0-A, 3x1x70/16mm², 20kV.
8. Ndërtimi i kanalit kablovik me gypa për shtrirje të kabllit 10(20)kV:
 - 2 gypa Ø 200mm (tip i kanalit K-3);
 - 4 gypa Ø 200mm (tip i kanalit K-1);
 - Me shtrirje të lirë (tip i kanalit K-5)
9. Ndërtimi i pushtave me dimensione: (2.0 x2.0x2.0)m.
10. Shtrirja e LP kabllorik 10(20)kV të tipit XHE 49-A 1x150/25mm².
11. Sipas projektit do të bëhet shpimi nën rrugë të asfaltuar, do të bëhet prerja e asfaltit apo betonit nëpër rrugë e trotuare, demontimi i trotuareve prej elementeve të betonit dhe riparimi i tyre (kthimi në gjendje të mëparshme).



Sqarim:

- a) Të anulohet kërkesa me nr.07-351/03-13972 dt.28.05.2021 dhe kërkesa nr.07-351/02-38097 dt.20.10.2021 dhe të merret parasysh kjo kërkesë e fundit për arsye të revidimit të projektit në fjalë.
- b) Të ndërprehet kontrata për dhënien në shfrytëzim të pronës publike me nr.01-413/01-21522 dt.19.09.2022 në pjesën e parcelës nr.P-70705053-00209-0 ZK Orize, pasi që me revidim të projektit është ndërruar lokacioni i vendosjes së Stabilimentit të Ri tipi A1 dhe parashifet të vendoset në parcelën me nr.00435-0 ZK Orize.

	NJËSIA INVESTIMET	Nr.	KEDS-DIV-F-DIV-05
		Faqe	Faqe 2 prej 2
	KËRKESË PËR LEJE NDËRTIMI(PËLQIM) PËR HAPJEN E KANALEVE DHE NDËRTIMIN E TRAFOSTACIONEVE 10(20)/0.4kV	Versioni	1.0

Të bashkangjitur gjeni:

- Projektin e reviduar me nr. 3352 dt.20.04.2023
- Fletën poseduese dhe kopjen e planit me nr.00435-0 ZK Orize
- Kërkesat me nr.07-351/03-13972 dt.28.05.2021 dhe nr.07-351/02-38097 dt.20.10.2021

Besojmë se kërkesa e jonë do të shqyrtohet, sepse ndërtimi i këtyre objekteve elektroenergjetike do të përmirësoj dukshëm dhe në mënyrë kualitative furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në këtë regjion.

Nr. kontaktues: **049-790-341 (burbuqe.baruti@keds-energy.com)**

Me respekt,


Inxhinier për Bashkëpunim
me Institucione Qeveritare:



Burbuqe Baruti



Drejtori i Departamentit për Investime:



Faruk Gjokaj



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GJAKOVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Orize

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70705053-00435-0	Parcelë / Parcela / Parcel	6815



Shkalla/Razmera/Scale: 1:6894

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 25.04.2023

Koha/ Vreme/ Time: 10:22:28

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovohi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70705053-00435-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	1916-23
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	25.04.2023 - 10:19
Komuna / Opština / Municipality:	GJAKOVË / DJAKOVICA / GJAKOVË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Orize / Orize / Orize
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	GJAKOVË / DJAKOVICA / GJAKOVË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësies Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70705053-00435-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		6815	-1988		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Azhuruar Azurirano Updated
Meje			



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno kortiscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klasse Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area (m²)
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë/Put/Road		6815

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	PSH.RRUGET PUBLIKE	KCID0714238	ORIZE / ORIZE / ORIZE /			1/1	-1988	